



| | | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punlyena/Predato Received/Delivery | 09-03 | 2021 | 1 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKDMSHCK | 1065/2021 | | 1/3 | |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr.35/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi–Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesës A. Nr.35/2021, të datës 27.01.2021 të parashtruar nga ankuesja nga Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike “ *kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 09.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.35/2021 të datës 27.01.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 27.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 332/2021 të regjistruar me A.nr.35/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se ka qenë e diskriminuar nga organi punëdhënës lidhur me mos pagesën e shtesës materiale në vlerë prej 100 eurosh sipas Vendimit të Qeverisë se Kosovës Nr.02/32 të datës 25.09.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Ndërsa me datë 04.03.2021 Policia e Kosovës ka ofruar përgjigjen në ankesë me numër protokoll 99/2021, se bashku me provat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 332/2021 të datës 27.01.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; përgjigjen në ankesë me numër protokoll 993/2021 të datës 04.03.2021, Kontratën e Punës me Nr. Ref. 07/1-01A/0310 të datës 19.08.2014; Pershkrimin e detyrave të punës bashkangjitur kontrtaës se punës; Vendimin e Qeverisë se Kosovës Nr.02/32 të datës 25.09.2020,

Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.06/59 të datës 21.01.2021; e-mailin e datës 24.02.2021 nga për e-mailin e datës 24.02.2021 nga për e-mailin e datës 21.12.2020 nga për etj. e-mailin e datës 09.10.2020 nga te etj. e-mailin e datës 12.11.2020 nga te etj. e-mailin e datës 12.11.2020 nga te etj.me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht sipas Kontratës së Punës me Nr. Ref. 07/1-01A/0310 të datës 19.08.2014, Kolegji ka konstatuar se ankuesja bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës si dhe Ligjin Nr.03/L-0212 të Punës ka themeluar marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës në pozitën e punës „Infermiere”, në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Gjilan.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pranueshmerinë e ankesës ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë;* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.* Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës së ankuseses, Kolegji ka konstatuar se pozita “infermiere” hynë në kategorinë e pozitave të nëpunësve të shërbimit publik, kështu që ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit të Shërbimit Civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesja ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.35/2021 të datës 27.01.2021 të parashtruar nga ankuesja Sofije Shaqiri.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës bazuar në nenin 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, konstaton se zyrtarët publikë më status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit



Këshillë juridike: pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A. Nr. 35/2021

Rushit KAJTAZI

[Signature]
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj - DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

